

KUMTESA DHE SHENIME

KOSTAQ CIPO

NJË SY RRETH DORËSHKRIMIT TË SIMONIT

Shënim i Redaksisë. — Po botojmë këtu një artikull postum të të ndjerit Prof. Kostaq Cipos (1892-1952) mbi një dorëshkrim shkruar me alfabetin e njohur të Todrit në gjysmën e parë të shekullit XIX nga një tregtar Elbasanas që ngjan të ketë frekuentuar tregjet e Polonisë, Trieshtën, Vienën e Hungarinë. Për këtë dorëshkrim ka folur së pari Prof. Dhimitër Shuteriqi «Anonimi i Elbasanit. Shkrimi shqip në Elbasan në shekujt XVIII-XIX dhe Dhaskal Todri» Buletin i Institutit të Shkencave III, 1, fq. 43. Aty epet edhe ndonjë informatë mbi të, dhe transkribimi i një fragmenti, i një recete ngjyrosjeje. Dorëshkrimi sot gjindet në Arkivin e Shtetit. Ai është transkribuar nga Qemal Haxhihasani.

Kjo vepër e dalë nga dora e Simonit kap 180 faqe. Me përjashtim të faqeve të bardha, puna e Simonit përfshin: shprehje, mënyra të foluri, kuvëndime, emra manufakturash e monedhash, prime grash për të shëruar sëmundje të njohura, si shpirrën, kollën, të ftohtit etj. dhe receta si të ngjyemjë bukur në katër pesë ngjyra të ndryshme. Një pjesë e madhe e këtij brumi, me përjashtim të primeve dhe të recetave, është radhitur gjermanisht, sllavisht, italisht (dialekti venecian) me përkthimin shqip për kraht.

Fjalët e shqipes si dhe ato të gjuhëve të huaja nuk janë shkruar siç shkruajmë ne sot duke çkoqur e veçuar njerën fjalë prej tjetrës. Dua të thom që në këtë dorëshkresë cdo fjalë nuk formon një individ më vete me kufi të caktuar. Këtu pothua çdo fjalë është lidhur e qepur pas shoqes që pason, dhe kjo e dyta pas së tretës e kështu gjersa merr fund tërë fjalja ose edhe tërë perioda.

Për të patur një ide të kësaj mënyre së lidhur, që nuk është rrallë tek ata që shkruajnë gjuhëra, të cilat kanë arrirë t'i mësojnë vetëm me vesh, po japim, si provë, disa shëmbulla: hudhetei = hudhe tei, tibaim-hesap = t'i bajm hesap; pritemkëtusenjime vi = pritëm këtu se njime vi; nenjiher = ne nji herë; shkojmegjesdisim = shkojm e gjesdisim; tishikopunëntate = ti shiko punën tate; përtuelendisun = për tu elendisun; mëbiempërtëluit = me bie mu për të luit; vjeneti = vjen ene ti; mevjen = më vjen u; mesetaha = me se ta ha; sekushmafali = se kush ma fali; e kevjedhun = e ke vjedhun; jopomadhavet = jo po ma dha vet; kukeqenqiskeardh = ku ke qenë qi ske ardhë etj.

Ndodh herë herë që ngjitet e tërë fjala pas shoqes që pason. Fjalës së përparme i pritët vetëm bishti i cili i ngjitet kokës së fjalës që ka për-

para. Dhë që ta thomi jasht metaforës, nga fjala e përparme këputet rrokja fundore ose më drejtë fonema fundore e kësaj rrokje d' e lidhet proklitikiisht me kryet e fjalës që pason kështu që të duket sikur ke përpara syve një corape të re të arnuar gabimisht. P.sh. tëmarrishateraqi r'keqe qi kaer espihet. = të marrish ate raqin e keqe qi ka er e s'piket.

T'u hedhim tani nga një sy faqeve për të parë më çkoqur se ç'kanë brënda. Gjysma e faqes së parë është zënë me fjalë gjermanisht dhe gjysma tjetër me përkthimin e tyre në gjuhën tonë. Gjysma e faqes së dytë është zënë me fjalë greqisht dhe gjysma tjetër në vënt që të jetë shqipërimi i fjalëve greke ka të radhitur emrat e muajve shqip duke mos nisur as nga janari, as nga marsi, po nga mai.

Faqja e tretë si dhe e gjashta dhe e shtata s'kanë nonjë gjë që të bjerë në sy. E katërta ka vetëm numura.

Fjalë të tregëtisë e të reshperisë ka faqja e pestë ku bëhet fjalë edhe për monedha ari që sot nuk dëgjohen më si **fiorinto**, **maxhar**. Radhët e faqeve tetë e nëntë janë musi raftet e një dyqani me manufakturë: topa me kadife, me kambrik, me basme, me pambuk dhe me çmimet përkatëse. Dhjetë faqet që pasojnë janë me fjalë greqisht me përjashtim të faqeve 24 e 25 që janë thjesht të bardha.

Fjalë e shprehje italishte përfshihen brënda faqeve 24-28 me përkthimin shqip iuxta, po për italishte duhet të kuptohet dialekti venecian me të cilin kish, si duket, pak familjaritet Simoni yn, meqë me Venedik ipte e mirte.

Prej faqes 41--66 cdo radhë nuk ka më tepër se dy tri fjalë italisht me shqipërimin krahas. Kështu edhe gjashtëmbëdhjetë faqet që pasojnë (68-83) s'kanë më tepër se dy tri fjalë të huaja me përkthimin shqip pranë.

Faqet 84-89 duket sikur janë çkëputur nga një gramatikë se janë mbushur me fjali të shkurtëra pavetësore të ndërhuara me anë të foljes **me qenë** dhe të një emëri.

Nga faqja 90-97 cdo radhë nuk ka më tepër se një fjalë a një folje dhe të gjitha këto janë vetëm shqip. Më interesante janë faqet 97-102 ku kemi një numur recetash.

Një kësosh na mëson si t'i heqim rakisë erën e keqe, një tjetër na tregon si të bëjmë verë të mirë dhe që të rrojë shumë; një recetë tjetër është si të ngiyejmë bojë të kuqe, një tjetër është për bojë ideje, një tjetër akoma për bojë të zezë.

Faqet 103-104 kanë fjalë italisht dhe shqipërimin e tyre. Tri faqet që vijnë më poshtë kanë fjalë e shprehje vetëm shqip. Bie në sy faqja që është plot me lokucione pavetësore si: **asht mirë**, **asht krym** etj.

Gjithashtu edhe tri katër faqet që pasojnë po me të tilla shprehje e me urime janë zënë. Prej faqes 115-122 kemi fjalë e folje në kohëra të ndryshme dhe vetëm shqip. Nga faqja 123-132 kemi fjalë sllavisht me përkthimin shqip anës.

Nga faqja 136 e poshtë gjejmë prime grash, prime për të shëruar shpirrën, një prime për kollën, një për të ftohtit, një prime për të luftuar qimezën dhe një tjetër për iriqthin.

Nga faqja 139 e tutje na jep një radhë udhëzimesh për të ngjyer: **bojgjake**, **boj ideje**, **boj alle**, **boj e zezë**.

Shqipja në të cilën është shkruar dorëshkrimi le udhën të hapur për hipotezën që të jetë një shqipe e përzier d.m.th. një dialekt gegë plot me toskizma ose një dialekt toskë me shumë gegizma. Kjo gjë del në shesht

nga sistemi fonetik. Që shqipja e Simonit është një dialekt i përzier provohet nga togjet zanore të cilat herë ruhen të plota si në toskënishtet, herë monoftongizohen e thjeshtohen si në Shqipëri të Mesme. Autori përdor lirisht **dua** dhe **du**; **umbarua** dhe **umbaru**; **dual** edhe **dul**; **l**) ta lyej dhe ta lyj; për të njyer, për të ngjymun;²⁾ mos u siell dhe mos u sill, po zien dhe do të zii; ta ziesh dhe ta zish³⁾.

E njëjta gjë mund të thuhet për togjet bashkëtingëllo-e: **mbyll** derën dhe ta myllish; **mbush** po : **mlumun**; **zembraime**. po : **humi** 4). Ve'ëm togu bashkëtingullor **nd** është përgjithësisht i vetëmi që ruen trajtën e vet. Gjejmë: **ndis**, më mundon, me shëndet, mundumun, ndif, prej shëndit, pash andërr, u pendove, me rend, me nder, mend, mundafsh, mrenda, smëgjend, më vjen të ndyt, e ndeza; dhe vetëm 2shembëlla kemi ku togu është thjeshtuar në një **n** dhe këto dy shëmbulla janë të fjalës ndëgjoj: e nëgjuat ta nëgjoj, dhe s'ka tjetër shëmbull.

Pothua tërë çka inovuar gegënishtja në punë të participit përfaqësohet në dorëshkrimet të Simonit, ku mungon vetëm participi toskërisht më napashtesën **-uar** i cili këtu përfaqësohet trimërisht me participin që sos mbë **-uam** siç e kanë shqipëtarët e Italisë dhe veçanërisht ata të Siqelisë. Ja disa shëmbulla: duhet **paguam**, kemi **harruam**, e kam **lënguam**; më ke **idhënumun**, ke **bamun**, më ke **mundumun**, kam **blemun**, asht

1) Ja lista e plotë e rasteve me **ua** e e atyreve me **u**:

Shëmbulla ku ruhet togu zanor **ua**

F. 29 nuk dua, nuk duam; 29 zdua të shkoj; 30 duhet paguam; 31 kemi harruam; 32 brisk që rruan; 32 mbuluam, zbuluam; 35 muaj; 36 mua, luan, grua; 39 e kam lënguam; 43 e kam mësuam; 47 më dual mendsh; 49 më luan; 50 e nëgjuat, e huaita; 52 u kujtuash, gjuaje; 53 dua ta di; 54 i tërbuam; 59 më tepruan; 59 kalem qi shkruan; 60 mëshi duart; 63 kemi për të çuam, kua; 66 druase; 80 me se të duash; 83 zdua ma; 86 asht e huaj; 89 muar valë; 101 pra si ta bluash; 113 më ruash; 131 sapua; 138 të thuash; 120 të paguai; 178 e quain; 178 ep kuai. Shëmbulla ku është mbledhur togu **ua** në **u**: f. 26 du të baj reshperi; 32 mbulum, zbuim; 37 bajame të qirume; 65 përse të mos e runi; 66 për të shkum; 102 ta bluish; 102 mos e bluish; 106 u bash për të rrum; 108 falma mu këte; 108 e du për peshqesh; 114 qenka e lëmume; 120 i dul gjak; 122 shuje; 125 u mbaru; 127 e mbarumeje; 129 qeshte me mu; 130 e rrecush; 139 kur të dush.

2) Ja lista e plotë e rasteve me **ye** ose **y**:

f. 53 pyet; 61 ka karcyem; 65 më pyet, pyetë; 83 pyete, pyeta; 89 e thyme; 97 qi ngjyen; 97 kur të ngjyeish; 99 të ngjyej; 100 të ngjyej boi ideje; 101 pra kur të ngjyeish; 110 se çdo të pyes; 110 pyetëm; 123 desha ta pyes; 32 asht thymun; 58 për të njymun; 77 e pëlqyshme; 114 e shkëlqyka; 113 kam thymun; 137 ta lvi; 138 ta lyj me mjalt.

3) Shëmbulla ku ruhet togu zanor **ie**:

f. 45 më përciell; 56 diell; 59 e mbijell; 73 i zien; 89 po zien; 97 ta shtijesh; 97 ti shtiesh; 100 e të ziein; 101 të marrish mishin e ta ziesh; 102 ene kur ta zieish; 114 si dijell, leu dielli; 117 shkon nga perndon dielli; 120 të jet, paranfiell; 127 mos u siell; 136 e ti shtiesh; 137 do shtiesh; 138 e ti shtiesh plagës.

Shëmbulla ku rrëgjohet e mblidhet togu në **i**:

f. 86 i zimun, pazimun; 98 dot zii fort; 100 ta zii; 100 ta zi; 100 e ti zi gjithë bashkë; 101 pra si të zi; 102 ta zish; 102 e të zin gjithë bashk; 138 t'i zii; 139 e të zii fort; 139 e ti zish fort.

4) f. 32 mbulum, udhmar; 32 mbushëm; 34 zembraime; 35 mbam; 43 e mbe-sa; 46 zybyll; 59 mbillet; 61 dhambët; 63 e mba un; 76 mbyll derën; 96 mbaie; 98 mbrenda; 107 dembel; 112 mbahu; 112 mbahe; 115 mbille, e mbolla; 121 kur të të vi mbar; 123 sunembamend; 34 hum; 37 mosutrem; 58 kalemplumbi; 59 asht mlumun; 67 asht mlumun; 71 masandai; 81 e amël; 84 mleth, po mledhim; 87 e shtremët; 88 plum; 92 i humi; 97 mrenda; 99 mrenda; 100 mrenda; 109 krym; 127 humi; 136 ta myllish.

i dhënum, asht bam, nuk ke vum, mbulum; më ke djegun; jan resitun, më ka marrun asht pjekun, e ka viedhun, kam voitun 1).

Ndonëse shkruan në një dialekt të përzier, dorëshkrimi i Simonit nuk na jep asnjë shëmbull të rotacizimit të nazales që vihet re në toskërishtet, po që konstatohet edhe në disa zona ku flitet një dialekt i përzier siç është krahinë e Shpatit, Bërzeshita dhe nonjë krahinë tjetër që unë mund të mos e di. Simoni nuk ka asnjë shëmbull si ajo e Shpatit: **kam barë**. Po kemi dhe zona tjera me dialekte të përziera si p.sh. atje ku dialekti gegë i Dib-rës piqet me viset e Toskërisë dhe ku gjejmë shumë toskizma, veç se nuk do harruar se dialekti i dorëshkrimit nuk duket të jetë shumë afër Dib-rës, sepse s'kemi mundur të gjejmë as një a jo që të jetë velarizuar, po as edhe pshikur nga ky fenomen siç është dialekti i Dib-rës e ka bile edhe të thekësuar, sepse a-në atje e gjejmë të ndërruar në o, p.sh. jon, kon etj.

Një pikë morfologjike, ndonëse vetëm një pikë, më shtyn të meitoj se vendlindia e Simonit mos jetë një zonë jo fort lark atyreve të populluara me sllavë apo që kanë pësuar influencën slave nga të dhanët e të marrët që kanë pasur me ta. Ky fenomen morfologjik është përdorimi i vetës së tretë në një të prezantit të indikativit atje ku duhet të ishte veta e tretë njëjës e koniuktivit. Siç dihet sllavishtja s'e ka koniuktivin, dhe shtie në punë indikativin edhe për të zëvendësuar atë. Kështu gjejmë: të han për të thënë: të haië; të blen për të thënë: të blej. Po nuk përjashtohet që edhe shëmbulla me koniuktif ka dorëshkrimi.

Një tjetër gjë për të vënë re është se fjalët dyrokëshe që sosin mbë -e të pathekës kur çquhen, nuk e flakin atë fonemë. Kështu kemi: kofeja, faqeja, imeja, joteja, gur gëlqereje.

Një tjetër fenomen për të vënë re është se si i ngjitet mënyrës urdhërore, enklitikesht, trajta e shkurtër e dhanores së përemërit vetor të vetës së parë: më. Kjo dhanore përemër tek që në toskërishte i qepet imperativit ashtu siç është: folmë, dëgjomë, mbamë, etj., te Simoni i lidhet imperativit gjithashtu enklitivisht, po duke pësuar fenomenin e metatezës si: piqëm, bjerëm, mbushëm, pritëm dhe kur sos imperativi mbë zanore, ahëre në vënt të përemërit më të metatetizuar në ëm, kemi vetëm -m si: dëftem, thymi, mbam etj. Ky lloj imperativi është gjallë edhe në shqipen e shqiptarëve të Siqelisë: «mirrëm vesh».

Qëmetime.-

1) Në vënd të asi, kësi, aso, këso; asish, kësish, asosh, kësosh gjejmë te Simoni ndërrimin e fërshëllores dentale s në alveodentale gjysmë-

1) Ja pasqyra e plotë e trajtave të participit

a) — uam: f. 30 duhet paguam; f. 31 kemi harruam; 32 mbuluam, zbuluam; 39 e kam lënguam; 43 e kam mësuam; 63 kemi për të çuam;

b) — mun: f. 27 e aimëkaqumun, prumun, ke bamun; 32 mbarumun, thymun; 40 më ke idhënumun; më ke mundumun; 86 zimun, pazimun; 89 mbarumun; 100 kullumun; 133 kam thymun; 134 jam blemun.

c) — m: f. 32 mbulum, zbulum; 60 idhënum; 93 asht idhënum; 32 asht bam; 42 nuk ke vum.

ç) — un: f. 32 ardhun; 40 më ke djegun; 59 a jan resitun; më ka marrun; 47 asht lodhun; asht grisun; 63 më ke rreitun; 74 kur kam ikun; 87 përfun; 89 e ke viedhun; 103 ikajetun; 134 kam ardhun; 177 kam voitun.

d) — zero: f. 40 më ka dhan zahmet; 41 jam zan; 92 ashtumbyll, 134 kam marr; 177 kam voit.

okluzive **c** siç e ka edhe të folët e Elbasanit. Ja dy tri shëmbulla: no-njanën **këcosh**; aco likure; të marri aci voi. Kështu edhe **cipër** e jo sipër.

2) Foljen gjysmë ndihmëse **mund** me pjesëz mohimi e përdor në trajtën **sun** dhe jo në trajtën e plotë: **smund**. Kështu shkruan. **suneci**, **sunebai**, **sunflas**, **sunithash**. Herë herë, nazalja fundore e kësaj trajte së rregjuar bie dhe kemi: **suvi** (= sunvi).

3) Përdor: **prim** e **prum** duke ndërruar bilabialen e tingëllt **b** në **p** kështu pra në vënd të **brum** ka pothua **prum** dhe në vënd të **brimë** ka gjithkund **prim**; po nuk mungon edhe fjala: **brum**.

4) Fjalët: **gjashtë** dhe **fort** i përdor disa herë edhe pa dentalen fundore. Kështu më një vënd shkruan: njapesagjash; talajfor, po ka vëndë ku thotë: **fort** e **fort**.

5) Fjala «derhem» është pothua kudo e përdorur me dentale të shurdhët dhe me metatetizimin e rrokjes parafundore. Kështu në vënd të fjalës: **derhem**, lexonjësi do të gjejë: **trehem**. Ky shurdhim i bashkëtingëlloreve të tingullta nuk shtrihet kudo po kufizohet vetëm te fjalët: **prim**, **prum**, **trehem**, **nishatë**. Një fenomen të tillë, po në stil të gjërë, na e jep vetëm fjalorthi i Marko Boçarit.

6) Në mos qoftë gabim transkriptimi ose mungesë zhdërvjellëtie në të përdorur të abecesë së Todhrit vemë re se përdor në vënd të shkronjës **xh**, në disa rasa natyrisht, shkronjën **ç**. Kështu shkruan: **çesme** për xhezme; **tençere** për tenxhere. Edhe fonemën **x** e ndërron herë herë në **c**. Shkruen pra: **ucërrua** në vënd të **uxërrua**, tençehet për: **të nxehet**.

7) Fjalën **pra** rallë e ka Simoni si ndajfolje me kuptim përmbjllës. Nga studimi ynë del se kjo fjalë është përdorur më fort me kuptim të ndajfoljes kohore: **pastaj** dhe, rrallë tek, edhe në vënd të lidhëzës **edhe**. Ja një dy shëmbulla: pra si ta heqi=pastaj. . . .; pra si ta qisi=pastaj si ta qisi; pra si ta pi=pastaj si ta pi ose: edhe si ta pi. Në vënd të fjalës **pastaj** përdor edhe elbasançen «jani».

8) Fjala **mjeç** është e vetmja lidhëze kohore që përdor autori për fjalët «gjer», «deri» ose «mjet» të Budit ose «djeri» të Buzukut. E ndërton këtë fjalë duke e shoqëruar me një **ke** dhe me folje në mënyrë lidhore. Kështu thotë: **mjeç ke** të shkoj; **mjeç ke** të zan si kua. Kjo lidhëze mund të ndërtohet edhe me «qi» dhe me folje në mënyrën lidhore: **mjeç qi ti shkoj**; po ka edhe: **mjeç këtu**, **mjeç atie**.

9) Fenomeni i aglutinacionit përfaqësohet vetëm me fjalën «ndui» (= ndë ui) dhe «ndor» (= në dor), tjetër s'kemi gjetur.

10) Ka vetëm «asht» dhe as «është» as trajtën e shkurtër «a», që e ka fort në përdorim Elbasani, nuk i ka.

11) Ka «dhiet» po jo **dhit** e **dhjet**, vetëm në një vënd ka: «dhijet».

12) Ka «koho» dhe «coho» që dëgjohen anë mbanë Elbasanit dhe në tërë veprat e Budit.

13) Përdor lirisht herë: **likurë** dhe herë **lëkurë** d.m.th. (i~ë), po është një fenomen që nis e merr fund po në këtë fjalë, nuk shtrihet edhe më tej. P.sh. shkruan **lëshoj** dhe kurrë **lishoj**; thotë: **lëshoje**, e **lëshova**, mbanje mos e **lësho**.

14) **ç**, **çfarë** janë përfaqësuar nga «qish». P.sh. Qish punë ke; a gjejm këtu se qish të hamë ?

15) Shprehja «ç'dert kam un» nuk pranohet të jetë e vendlidjes së autorit të dorëshkrimit, sepse është një mënyrë të foluri që dëgjohet në Veri, andaj mendimi ynë është se kjo do të jetë përvetësuar nga Simoni gjatë udhëtimeve që bënte në Venedik e në Trieste për të

blerë mall ku ka pasur. duket, shumë komisionarë shkodranj me të cilët kryeshe autori yn.

16) Nonjë folje intransitive, si p.sh. foljen «me ardhë», e zgjedhon herë me foljen ndihmëtare «kam» si: **ke ardhun**, herë me folien «jam» si: **jem ardhun**, dhe kjo është akoma një shën'ë tjetër e të pshikurit të dialektit të Simonit nga influenca e gjuhës sllave.

17) Ashtu siç thomi ne: lule **dhensh**, voj **ullish**, corbë **derrash** Simoni ka edhe terezi **florish**, tek që ne sot thomi: terezi **florini**, e jo **florish**.

18) Kudo që i bie puna të zërë ngoje mundafshin. shkruam: mondafsh. Se ku djalli dëgjohej kjo trajtë, bëj be që nuk e di. Një herë e ka tepruar zullumin se në vend që të shkruajë: **nuk e shof**, ka shkruar: **nokeshof**, ndofta kjo trajtë mund të jetë një lapsus calami me që nuk është përsëdytur.

19) Në vend të foljes: **zgjoj**, ose **sqoj** ose **çgjum**, Simoni përdor vetëm trajtën e Elbasanit: **qoj**, P.sh. të **qoi**, të më **qoish heirët**.

20) Thotë: **bana zarar**, tek që elbasanasi thotë **bana qeder**.

21) Përdorimi i trajtës «raqi» siç e shqyptojnë grekërit e grekofonët dhe aromunët dhe jo raki siç dëgjohej kudo në Shqipëri le arallëk për hipotezën që Simoni të ketë pasur të dhën'ë të marrë të dendura edhe me grekët ose me aromunët.

22) Po rradhitim këtu disa shprehje të dorëshkrimit: **me perdhun**, **me të prapmet**, **në nesëret**, **kotnasikot** (sic), **tënças**.

23) Fjalë turqishte ka këto: hoshnut, karshi, karaboi, ustaishi (punë ustai), hararet, ferk, kondak dembel, soisëz, ta kaplladishish, më karshitet; borçëli, sakat, ustallëk, zarar, shamat, sahat.

24) Fjalë me kuptim të panjohur: **zerdexok**, **topaç**, të **gjëshymit**, **ijograf**, **kalatash**, **akshar**.

25) Trajta t'Elbasanit: **neun** (= dhe unë) punën **tate**, kush të **det**.

26) Ndërtimi i fjalive lidhore është për qejf, se autorin për fat të mirë, nuk e shqetësojnë kostruktet e gjuhëve të huaja, andaj shkruan popullorçe, d.m.th. shqip: **qi më ka dhanë ai mue** dhe jo si shkruajnë shkrimtarët tanë: «qi ai më ka dhanë mua» që është një ndërtim neolatin, dhe jo shqip.

27) Atë shprehje që përdorim ne sot: «e kam jetuar vetë këtë ngjarje» duke dashur të përkthejnë me këtë fjalë italishten: **rivivere** ose gjermanishten **erleben**, Simoni, si pa dashur, na ka falur një fjalë më të mirë, fjalën «lëngo». Kështu thotë: **e kam lënguan**, me kuptimin l'ho rivisuto.

28) Në një farë vendi, na jep aspektin ingresif të foljes «me bim». Ja se ç'thotë: sa të pëlçasi koqeja, sa të njifet **se ka hym me bim**. Frazat: **se ka hym me bim** formon vetëm një kuptim, se ajo nuk jep aspektin inkoatif, qoftë edhe me mjete leksikore, të foljes **me bim**.

29) **Sandhi** që vihet re në këto 180 faqe të dorëshkrimit të Simonit, është qi i jashtmi (euphonie externe) dhe i kufizuar vetëm në të njëjtat shembulla: **Zdua**, **zbuluam**, **zdo**, **zvëjen** dhe po këto shembulla përsëriten kudo.